

A photograph showing several children sitting around a wooden table, engaged in drawing. One child in the foreground is using a brown pencil to draw on a piece of paper. Another child is using a blue marker. There are various drawing supplies on the table, including a black tray with colored pencils and markers. The children are wearing colorful clothing, and the background is a solid blue color.

RAPORTI VJETOR 2020



HANDIKOS

SHOQATA E PARAPLEGIKËVE DHE E PARALIZËS SË FËMIJËVE TË KOSOVËS
ASSOCIATION OF PARAPLEGICS AND PARALYSED CHILDREN OF KOSOVA
UDRUŽENJE PARAPLEGIČARA I DEČJE PARALIZE KOSOVA

PËRMBAJTJA

• Parathënie.....	1
• Përmbledhje ekzekutive.....	3
• HYRJE.....	4
• Projektet e implementuara përgjatë 2020.....	8
• Shërbimet e ofruara përgjatë 2020.....	11
◦ Shërbimet ditore për fëmijë.....	12
◦ Shërbimet ditore për të rritur.....	15
◦ Shërbimet e pajisjeve ndihmëse.....	18
◦ Shërbimet juridike.....	20
◦ Shërbime të tjera.....	21
• Intervenimet avokuese dhe lobuese.....	28
• Publikime.....	30

HANDIKOS është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Studimet tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesjes shoqërore konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i rolit të shtetit, prandaj përfitimet nga përkujdesja janë pjesë e të drejtave të individit, qasje kjo që anasjelltas ofron suksesin ose dështimin e përkujdesjes ndaj personave me aftësi të kufizuara, e që për shumë arsye është vendimtare për mirëqenien e shoqërisë.

Sipas **Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, gjendja e tanishme e personave me aftësi të kufizuara nuk përmbushë realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj, si rrjedhojë, të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, e theksojmë se institucionet e Kosovës kanë akoma shumë punë dhe përpjekje për të bërë.

Viti **2020**, ka qenë sfidues për të gjithë, vit i cili ka sjellë vështirësi të mëdha e i cili karakterizohet me **COVID-19**. Duke u ballafaquar me këtë gjendje ende të panjohur për mbarë njerëzimin, edhe ne si organizatë kemi qenë të shtyrë të mobilizohemi dhe të përshtatim planet e çdo projekti apo programi, madje duke dalë tej tyre me të vetmin qëllim, gjetjen e mënyrave dhe formave më të mira në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara, përmes këshillave por edhe përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë me pajisje të ndryshme. Fatkeqësisht **COVID-19** nuk ka kursyer as personat me aftësi të kufizuar por as personelin dhe vullnetarët e hershëm që kanë qenë të angazhuar në shoqatën tonë vite më parë, siç ishin R. K. dhe F. Z.

Përkundër kësaj situate, **HANDIKOS** ka vazhduar të punojë në ngritjen e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara, duke lobuar dhe avokuar për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me kushte të barabarta për të gjithë.

Synimet tona kryesore gjatë **2020**-ës kanë qenë të fokusuara në katër **(4)** objektiva:

- Avokimi dhe lobimi drejt mbrojtjes dhe avancimit të të **drejtave** të personave me aftësi të kufizuara në përfshirjen e tyre në legjislacionin e Kosovës;
- Vazhdimësia në ofrimin e **shërbimeve** për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, të cilat janë primare dhe më se të nevojshme por që ende mbesin një sfidë;
- Mbështetja e personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre përgjatë **pandemisë**;
- Ngritja e **kapaciteteve** të personave me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe personelit të HANDIKOS.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë sfida e barriera në vendin tonë, ndër të cilat ende mbesin: qasja, edukimi, punësimi, mirëqenia si dhe respektimi dhe avancimi i të drejtave të tyre, duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare. Kur përmendim sfidat, gjithsesi këtu duhet përmendur në veçanti edhe sfidat me të cilat HANDIKOS ballafaqohet, duke u bazuar 100 % në projekte, pa asnjë mbështetje të përhershme sidomos kur kemi të bëjmë me shërbimet të cilat ende nuk ofrohen nga institucionet vendore.



Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë në tërësi dhe atyre duhet t'u ofrohet mundësia drejt pavarësisht individual, ku përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit tonë.



Afrim Maliqi
Drejtor

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor – 2020 paraqet një pasqyrë përmbledhëse të të arriturve të HANDIKOS përgjatë vitit **2020** në kuadër të programeve të implementuara. Të dhënat e raportuara janë të bazuara në të arriturat e HANDIKOS-it në implementimin e projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe atyre të huaj. Përmes shërbimeve të ofruara përgjatë një viti për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe prindër/familjarë të tyre, HANDIKOS ka vazhduar misionin e saj për të avancuar situatën e aftësisë së kufizuar në vend. Për më tepër, përgjatë një viti, puna e palodhshme e HANDIKOS ka ndikuar dukshëm në ruajtjen e mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre gjatë **COVID-19**.

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka ofruar shërbime direkte për **30 fëmijë** me aftësi të kufizuara dhe **38 të rritur** me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës. Njëkohësisht janë ofruar shërbime të pajisjeve ndihmëse për **501 persona** me aftësi të kufizuara në Kosovë. HANDIKOS gjatë vitit 2020, ashtu sikurse në vitet e kaluara, përmes këshillave ligjore ka ndikuar në përmbushje të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara. Përgjatë një (1) viti, 600 të tilla janë ofruar për personat me aftësi të kufizuara në mbarë Kosovën, 60 prej të cilave kanë qenë ankesa dhe padi.

Fokus qëndror gjatë këtij viti ka qenë mbështetja e komunitetit të aftësisë së kufizuar në ruajtjen e shëndetit të tyre gjatë pandemisë, prandaj përveç shërbimeve direkte, fëmijët me aftësi të kufizuara, të rriturit dhe familjet e tyre janë mbështetur përmes sesioneve informuese, videoanimacioneve informuese dhe miqësore, shpërdarjes së materialeve ushqimore, higjienike, shëndetësore dhe didaktike, me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe lehtësimit të funksionimit të tyre në kushte të shtëpisë.

Bashkëpunimi i ngushtë që **HANDIKOS** ka vazhduar ta mbajë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet lokale dhe qendrore, shoqërinë, dhe vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka ndikuar dukshëm në funksionimin e përditshëm, adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe avancimin e situatës së tyre në shoqëri. **HANDIKOS** vazhdon të punojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara.

.

HYRJE



HISTORIKU

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar më 1983, me iniciativën e z. Halit Ferizi, kryetar i atëhershëm i shoqatës dhe më vonë lider i lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë, së bashku me një grup të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Objektivi kryesor ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë”, përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Prej themelimit e deri në ditët e sotme, HANDIKOS është përkrahur nga një numër i konsiderueshëm i organizatave ndërkombëtare dhe vendore të cilat i kanë mundësuar HANDIKOS ekzistencën për më shumë se dy (2) dekada. Në fillimet e saj, HANDIKOS mbështetje të madhe ka pranuar nga: “Handicap International”, “OXFAM”, Agjencia Finlandeze FIDIDA, Qeveria e Finlandës, Ambasada e Finlandës, Organizata Italiane “Onlus Wamba-Athena”, “Onlus Roberto Bazzoni”, “Save The Children”, “UNICEF”, Agjencia Evropiane për ndërtim dhe rindërtim, mbështetës të cilët kanë mundësuar misionin dhe vizionin e HANDIKOS.

Pavarësisht mungesës së statistikave vendore për numrin dhe prevalencën e aftësisë së kufizuar në vend, në databazën e saj, HANDIKOS numëron më shumë se **18,000** anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme në mbarë Kosovën. HANDIKOS ka ofruar shërbime sociale në komunitet dhe shtëpi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familjarët e tyre. Për më tepër, përgjatë gjithë kësaj përvoje, HANDIKOS është orientuar gjithashtu edhe në avokim dhe lobim për njohje dhe respektim të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë duke intervenuar në vetëdijen e shoqërisë si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

HANDIKOS ndërvite ka modeluar dhe ofruar sete të ndryshme të programeve rehabilituese të cilat kanë mbështetur gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend dhe familjet e tyre. Të gjitha këto, janë ofruar përmes programit të **Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - RBB**, program ky të cilin HANDIKOS e ofron që nga viti **2002** në Prishtinë, Podujevë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Pejë, Istog, Mitrovicë; në kuadër të të cilave, sete të shumta të shërbimeve dhe teknikave avokuese janë implementuar. Së fundmi **HANDIKOS** në kuadër të programit të **RBB-së** është duke modeluar qasjen bio-psiko-sociale në të gjitha shërbimet e saj, qasje kjo e cila sheh personin në qendër nga këndvështrime të ndryshme.

Me gjithë veprimet që janë ndërmarrë viteve të fundit, personat me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në të gjitha aspektet jetësore të cilat u pamundësojnë atyre realizimin e të drejtave njerëzore dhe një jetese të dinjitetshme siç është reflektuar edhe në **Kushtetutën e Kosovës** dhe në aktet e tjera ligjore të vendit.

Bazuar në hulumtimet e fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, konsiderohet se rreth **15%** e popullsisë së botës kanë të paktën një aftësi të kufizuar. Në Kosovë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë figurojnë rreth **93.288** persona me aftësi të kufizuara.



HANDIKOS përgjatë vitit **2020**, të gjitha programet e saj mbështetëse për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara i ka përshtatur bazuar në udhëzimet dhe rekomandimet e institucioneve vendore për parandalimin e përhapjes së **COVID-19**, situatë kjo e cila ka afektuar dukshëm rrjedhën tipike të organizatës. Përgjatë këtij viti, HANDIKOS ka vazhduar implementimin e **Strategjisë së saj Zhvillimore (2018 – 2022)**. Rrjedhimisht, e gjithë puna e **HANDIKOS** përgjatë vitit **2020** është determinuar në parimet dhe objektivat strategjike.

Përgjatë gjithë vitit janë ofruar dhe implementuar alternativa të ndryshme të cilat kanë lehtësuar implementimin e programeve aktuale si dhe përmbushjen e objektivave strategjike të saj, duke ruajtur shëndetin e qytetarëve të cilët i përfaqëson dhe jo vetëm.

VIZIONI YNË

Shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

MISIONI YNË

Të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre.

Në kuadër të **Strategjisë Zhvillimore (2018-2022)**, HANDIKOS objektiva strategjike të saj ka paraparë:

1. **Pjesëmarrja** – të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike;
2. **Punësimi** – të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës;
3. **Edukimi dhe Trajnimi** – të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në edukimin gjithëpërfshirës dhe mësimin gjatë gjithë jetës;
4. **Mirëqenia Sociale** – të promovojë kushte të jetesës së dinjitetshme për personat me aftësi të kufizuara;
5. **Shëndeti** – të përmirësojë qasjen në shërbime shëndetësore cilësore; &
6. **Zhvillimi Organizativ** – ngritja e kapaciteteve të HANDIKOS-it dhe organizatave partnere.



PROJEKTET QË HANDIKOS KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË 2020

- Promovimi i gjithëpërfshirjes në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regional - Kosova Gjithëpërfshirëse (2019-2023), mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian. Projekti zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës me mbështetje nga Bashkimi Evropian.**

Qëllim i përgjithshëm i projektit është një shoqëri gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të jetojnë një jetë të dinjitetshme si qytetarë të barabartë. Në kuadër të projektit janë paraparë këto objektiva:

- Reformat e qeverisë dhe administratës publike janë gjithëpërfshirëse për PAK;
- Fuqizimi i niveleve të ndryshme qeveritare për të draftuar, rishikuar dhe zbatuar një legjislacion gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar;
- Fuqizimi i dialogut të OPAK me parlamentin dhe Qeverinë në nivel lokal dhe nacional; &
- Përmirësimi i avokimit të përbashkët të OPAK dhe rrjeteve të tyre.

- Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë (2017-2021) - mbështetur nga Save the Children dhe SIDA Suedeze.**

Qëllim i përgjithshëm i projektit është të promovojë dhe adresojë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes përmirësimit të koordinimit ndër-sektorial dhe promovimit të masave të nevojshme për shtrirjen e aftësisë së kufizuar në të gjithë legjislacionin, politikat, sistemet dhe praktikën vendore. Projekti gjatë vitit 2020 është orientuar në dy objektiva kyçe:

- Sistemet lokale, formale dhe joformale, për mbrojtje të fëmijëve janë fuqizuar për të ofruar shërbime parandaluese, të qasshme, fleksibile dhe të ndjeshme ndaj gjinisë;
- Promovimi i llogaridhënies sociale të fokusuar tek fëmijët dhe masat e pjesëmarrjes së fëmijëve për të siguruar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e shërbimeve të duhura specifike.

- Avancimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve (2020-2022) - mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve.**

Qëllim i përgjithshëm i projektit është të kontribuoj rreth fuqizimit, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në shërbime sociale dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijë nga Organizatat e shoqërisë civile. Projekti gjatë vitit 2020 është orientuar në tri objektiva kyçe:

- Rritja e shkathtësive dhe njohurive të Qendrave për Punë Sociale dhe Organizatave të Shoqërisë Civile për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët e cënueshëm dhe familjet e tyre përmes shërbimeve psiko-sociale;
- Promovimi dhe inicimi i qasjes multi disiplinore në të drejtat e fëmijëve si dhe ngritja e kapaciteteve të Qendrave të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi .

PROJEKTET QË HANDIKOS KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË 2020

Avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë (2019-2020) mbështetur nga UNICEF.

Qëllimi kyç i projektit është avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë në fushën e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes aktive përmes avancimit të legjislationit aktual relevant me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe qasjen në shërbime të kualitetit të lartë të bazuara në principe të modelit bio-psiko-social. Në kuadër të këtij projekti synohet të:

- Inkorporohet modeli i programit të RBB-së i bazuar në principe të qasjes bio-psiko-sociale në Ligjin Gjithëpërfshirës si dhe në draft plotësimet e ardhshme në legjislaturën vendore, relevante me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Të fuqizojë iniciativat e shkollave për të avancuar/siguruar qasje në shkollat e tyre për fëmijët me aftësi të kufizuara (të të gjitha kategorive);
- Të rritet dukshmëria e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë; dhe
- Të fuqizojë rrjetin e Qendrave të RBB-së në Kosovë në adresimin e çështjeve relevante me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Avancimi i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja në shoqëri dhe kushtet për jetesë të pavarur për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Ballkanin Perëndimor, mbështetur nga Threshold Finlandë.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është avancimi i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja në shoqëri dhe kushtet për jetesë të pavarur për Personat me Aftësitë Kufizuara në Kosovë.

Projekti synon:

- Të avancojë kapacitetet e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara që të përmirësojnë standardet e jetesës.
- Të fuqizojë Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mekanizma bashkëpunues në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të integritetit të të drejtave të tyre në politikat e zhvillimit në të gjitha nivelet.
- Rritjen e ndërgjegjësimin të institucioneve dhe shoqërisë për të drejtat e PAK dhe promovimin e Avokimit të të drejtave të njeriut në mes të PAK në nivelin lokal dhe kombëtar.

Ngritja e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara dhe promovimi i mundësive të barabarta (Dhjetor 2020 - Mars 2021) - mbështetur nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Qëllim parësor i projektit është ofrimi i shërbimeve cilësore sociale me bazë në komunitet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe mbështetja e familjarëve të tyre në ballafaqimin e aftësisë së kufizuar në situata të përditshme. Përmes këtij projekti është synuar të arrihet:

- Përmirësimi i mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara;
- Përmirësimi i mirëqenies sociale të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

PROJEKTET QË HANDIKOS KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË 2020

Avancimi i mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara në Regjionin e Prishtinës

(Dhjetor 2020 – Maj 2021) – mbështetur nga Komuna e Prishtinës – Drejtoria për mirëqenie sociale.

Qëllim kryesor në kuadër të projektit është të përmirësojë mirëqenien sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Regjionin e Prishtinës përdorësynohet:

- Të përmirësohet mirëqenia sociale e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Të përmirësohet mirëqenia sociale e të rriturve me aftësi të kufizuara;
- Të rritet vetëdija e familjarëve në mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga përhapja e COVID-19;

Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës përmes prodhimit të strajcave të ri-përdorshme si mbrojtje ndaj mjedisit (Tetor 2020 – Prill 2021) – Mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë dhe implementuar në partneritet me The Balkan Forum.

Projekti në thelb ka për qëllim të promovoj mundësitë e barabarta për të gjithë, duke u theksuar në punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe promovimin e alternativave për mbrojtjen e ambientit. Në kuadër të projektit është planifikuar të arrihen këto rezultate:

- 10 persona me aftësi të kufizuara fitojnë shkathtësi dhe implementojnë ato në prodhimin e strajcave ri-përdorshme miqësore për ambientin
- 10 persona me aftësi të kufizuara janë punësuar dhe kanë prodhuar të paktën 3,000 strajca të ri-përdorshme;
- Rritet vetëdija e shoqërisë, bizneseve dhe politikë-bërësve për dëmet e përdorimit të qeseve të plastikës;
- Të paktën 10 dyqane janë përkushtuar në ruajtjen e ambientit duke promovuar dhe shitur strajcat ri-përdorshme.

SHËRBIMET E OFRUARA

HANDIKOS përgjatë vitit 2020 ka vazhduar të ofroj shërbime për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, familjarët, prindërit, kujdestarët, komunitetin në përgjithësi dhe shoqërinë Kosovare.

Shërbimet e ofruara për komunitet në kuartalin e parë të vitit janë ofruar duke u bazuar në modelet që HANDIKOS ka pilotuar dhe programuar ndër vite, duke ofruar kështu mbështetje holisitke me bazë bio-psiko-sociale si dhe duke u orientuar në pavarësimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. E gjithë mbështetja e ofruar për komunitetin që HANDIKOS përfaqëson është adaptuar në platforma virtuale, duke ndjekur udhëzimet e institucioneve vendore për parandalimin e përhapjes së pandemisë me COVID-19.

Në pjesën më poshtë janë të paraqitura të arriturat kyçe përgjatë vitit 2020 përgjatë ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.



SHËRBIMET DITORE PËR FËMIJË

HANDIKOS përgjatë implementimit të shërbimeve të ofruara në kuadër të Programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi, me mbështetje të projekteve që ka implementuar përgjatë vitit **2020**, të financuara nga donatorët vendor dhe të huaj, ka arritur të mbështesë **30** fëmijë me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës. Shërbimet kyçe të ofruara përgjatë këtij viti kanë mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve me theks në shkathtësitë ditore, zhvillimin kognitiv, fizik dhe atë emocional. Shërbimet e ofruara përgjatë vitit **2020** janë ofruar duke iu përshtatur rrethanave aktuale me pandeminë **COVID-19**.


HANDIKOS ka vazhduar vlerësimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi multidisciplinar i HANDIKOS duke vënë **fëmijën në fokus** si dhe duke analizuar perspektivën e prindërve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve (kur është aplikuar). Bazuar në rezultatet e vlerësimit, janë përpiluar plane individuale të intervenimit për çdo fëmijë përfitues, përderisa ri-shikimi i tyre është bërë në **baza tre (3) mujore** duke aplikuar procesin e ri-vlerësimit në të gjitha fushat e zhvillimit. Procesi i mbështetjes së fëmijëve përgjatë vitit raportues është zhvilluar përmes përdorimit të platformave virtuale, shpërndarjes së materialeve didaktike dhe angazhimit të prindërve për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve në kushte të shtëpisë, proces ky i cili ka kontribuar në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara. E gjithë kjo në baza mujore është raportuar për çdo fëmijë përfitues, ku më pas të njëjtat janë ndarë edhe me prindërit/kujdestarët duke i përditësuar ata me progresin mujor për fëmijët e tyre.

Të dhënat nga vlerësimi bazë i fëmijëve dhe ato nga ri-vlerësimi i fundit i realizuar në **Dhjetor 2020** tregojnë rezultate të kënaqshme të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara përgjatë **një (1)** viti, pavarësisht sfidave me të cilat janë ballafaquar fëmijët përfitues, ofruesit e shërbimeve si dhe prindërit e përfshirë në këtë proces.


Të dhënat demografike për fëmijët përfitues

30 fëmijë me aftësi të kufizuara	Të ndara sipas gjinisë	
	Vajza	Djem
	11	19

Shërbimet e ofruara përgjatë vitit **2020**, ishin të orientuara në mbështetjen e **zhvillimit të fëmijëve** në fushën e komunikimit (ekspressive & receptive), shkathtësive ditore (personale, domestike & komunitare), socializim (lojë, argëtim & ballafaqim), motorikë (grosë & fine). Përgjatë një **(1) viti** në kuadër të shërbimeve të ofruara janë mbështetur fushat e zhvillimit të elaboruara sipër, përderisa nga mesatarja e zhvillimit e kalkuluar në vlerësimet fillestare për fëmijët përfitues prej **52%** (niveli bazë i shkathtësive) është ngritur në **64%** (progresi i arritur për një **(1) vit** me **30 fëmijë** me aftësi të kufizuara).



Fushat në të cilat është identifikuar progres i dukshëm përgjatë vitit 2020 janë ajo e *komunikimit receptiv, shkathtësive ditore personale & domestike si dhe motorikës fine*:



Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara përgjatë vitit **2020**, dukshëm është afektuar nga pandemia me **COVID-19**, gjë e cila ka determinuar edhe natyrën e punës si dhe progresin e planifikuar për çdo fushë të intervenimit. Rrjedhimisht, **HANDIKOS** që nga muaji Prill 2020, duke shfrytëzuar burimet e saj, ka arritur të fuqizoj ofrimin e shërbimeve përmes alternativave të tjera të implementuara të cilat kanë mbështetur ciklin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët përfitues.

Përgjatë një (1) viti në linjë të mbështetjes së zhvillimit të fëmijëve në kushte të shtëpisë, si dhe prindërve përgjatë procesit të mbështetjes së tyre për fëmijët, janë ofruar edhe **257 pajisje/materiale didaktike**, të cilat janë selektuar duke u bazuar në objektivat individuale për çdo fëmijë përfitues. Materialet didaktike, janë shpërndarë në sistemin rotacion, ku fëmijët kishin qasje në to, për aq kohë sa është punuar në një objektivë të caktuar.




HANDIKOS për gjatë gjithë vitit, me resurset e saj, ka arritur të prodhoj **62** video udhëzuese, të cilat janë shpërndarë tek komuniteti përmes rrjeteve sociale të organizatës. Videot udhëzuese janë prodhuar me qëllim të ofrimit të alternativave shtëpiake për të mbështetur fëmijët, duke përdorur çdo herë materiale të cilat supozohet t'i ketë çdo shtëpi. **HANDIKOS** ka arritur mesatarisht rreth **500** shikues për secilën video të publikuar me këtë qëllim.

SHËRBIMET DITORE PËR TË RRITUR

HANDIKOS ka vazhduar punën e saj me dhe për personat me aftësi të kufizuara edhe përgjatë vitit 2020. Varësisht projekteve që ka implementuar, ka arritur që të punojë edhe për të rriturit me aftësi të kufizuara drejt jetesës së pavarur dhe shkathtësive për pavarësim. **COVID-19** ka vështirësuar dukshëm ofrimin e shërbimeve të kësaj natyre, kjo ngase nuk është treguar e lehtë përshtatja e programeve në forma virtuale.

Përgjatë një viti HANDIKOS ka arritur të mbështesë **38** persona me aftësi të kufizuara (20G & 18B) në formë direkte përmes ofrimit të shërbimeve sociale për jetesë të pavarur dhe njohje dhe funksionalizim të shkahthësive. Përfituesit e përfshirë në forma direkte janë të moshës 21 – 56 vjeç. Të arriturat kyçe janë relevante me rritjen e njohurive të personave me aftësi të kufizuara në ballafaqimin me aftësinë e kufizuar në jetën e përditshme; njohjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara; ballafaqimin dhe mbrojtjen nga infektimi me **COVID-19**; si dhe në fushën e mirëqenies sociale dhe psikologjike.

Në anën tjetër, **HANDIKOS** ka ofruar edhe shërbime në shtëpi, për persona me aftësi të kufizuar të cilët është vlerësuar të kenë vështirësi në marrjen e shërbimeve në Qendër. Gjatë **një (1) viti** nga ky shërbim kanë përfituar **21** persona me aftësi të kufizuara (13G & 8B) nga regjioni i Prishtinës. Kjo ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes së personave me aftësi të kufizuara për të drejtat njerëzore të cilat mbrohen me ligjet në fuqi, si dhe mundësitë për marrjen e shërbimeve nga insitucionet relevante apo të tjera.



Për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara, **HANDIKOS** ka zhvilluar edhe video udhëzuese të cilat për qëllim kishin mbështetjen e jetesës së pavarur dhe aktive edhe përgjatë pandemisë me **COVID-19**. Përgjatë vitit 2020 janë publikuar **shtatë (7)** video udhëzuese me qëllim të dhënies së alternativave të ndryshme për shfrytëzimin e situatës aktuale në favor të jetesës së pavarur. Videot e publikuara në rrjetet sociale të **HANDIKOS** kanë arritur një shikueshmëri prej **1000** shikues mesatarisht.

HANDIKOS ka mbajtur edhe sesione informuese virtuale gjatë vitit 2020 me **63** persona me aftësi të kufizuara (**37G & 26B**) nga regjioni i Prishtinës. Të njëjtat kanë ndikuar dukshëm në vetëdijësimin e komunitetit në menaxhimin emocional përgjatë pandemisë me **COVID-19**, vetëdijësimin për shfrytëzimin dhe identifikimin e aftësive të tyre si dhe ruajtjen e shëndetit të tyre dhe rrethit ku jetojnë. Për më tepër, këto sesione kanë ndikuar edhe në nivelin e të kuptuarit të komunitetit për udhëzimet dhe këshillat e ofruara nga institucionet e linjës, të cilat është dashur të përshtaten në një natyrë miqësore për aftësinë e kufizuar.






SHËRBIMET E PAJISJEVE NDIHMËSE

HANDIKOS ka vazhduar të mbështesë **personat me aftësi të kufizuara** në Kosovë edhe përmes ofrimit të pajisjeve ndihmëse për lëvizje, shërbim ky i cili ka mundësuar dhe kontribuar në pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, për më tepër ka kontribuar direkt edhe në përmbushjen e misionit tonë.

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka arritur që në mënyrë direkte të mbështesë **310** persona me aftësi të kufizuara (166G & 144B) në Kosovë përmes ofrimit të pajisjeve të ndryshme ndihmëse. Nga ta, **38** ishin fëmijë me aftësi të kufizuara dhe **272** të rritur. Kryesisht përgjatë këtij viti janë shpërndarë karroca standarde, karroca tualeti, paterica dhe shëtitore.

Çdo përfitues, fillimisht është **vlerësuar**, përmes inventarëve vlerësues që **HANDIKOS** posedon, inventarë të cilët pasqyrojnë nevojat e personit për përdorimin e pajisjes ndihmëse, si dhe specifikacionet e llojit të pajisjes ndihmëse dhe përmasave të saj. Pajisja ndihmëse është montuar dhe përshtatur me nevojat e përdoruesit të saj, përderisa të njëjtit janë **trajnuar** në përdorimin e shëndetshëm të pajisjes ndihmëse, mirëmbajtjen e shëndetit përgjatë përdorimit të pajisjes ndihmëse e gjithashtu edhe mirëmbajtjen e vetë pajisjes.

Shpërndarja e pajisjeve ndihmëse



Përgjatë këtij viti, **HANDIKOS** përveç fushave të tjera të bashkëpunimit me Rrjetin e Qendrave të Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi në Kosovë, ka bashkëpunuar ngushtë edhe në ofrimin e shërbimeve për pajisje ndihmëse. Vetëm gjatë vitit 2020, HANDIKOS ka ofruar **72 karroca dhe 69 pajisje** të tjera ndihmëse për lëvizje. Për më tepër, përgjatë këtij viti në kuadër të donacioneve të pranuar (pajisje ndihmëse), janë shpërndarë edhe **360 pajisje ndihmëse** për asistencë në lexim, tek organizatat të cilat përfaqësojnë personat e verbër.

Pajisjet ndihmëse të shpërndara tek personat me aftësi të kufizuara përgjatë 2020, janë donacion nga Fondacioni "*Ditët e Vona të Jezus Krishtit*" dhe donatorë privat.



SHËRBIMET JURIDIKE

HANDIKOS ka vazhduar të ofroj shërbimin e këshillimit juridik për të gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend edhe përgjatë vitit 2020. Për më tepër, për personat me aftësi të kufizuara, si një ndër grupet më të cënueshme në vend, ballafaqimi me situatat diskriminuese dhe anuese ka qenë shumë i dukshëm përgjatë periudhës me **COVID-19**.

Shërbimet juridike të ofruara përgjatë periudhës raportuese janë kryesisht relevante me rastet e diskriminimit, mohimit të të drejtave bazë të njeriut dhe parregullsi të tjera të cilat kanë të bëjnë me vështirësitë e personave me aftësi të kufizuara në gëzimin e benefiteve të garantuara me ligj.

Si rezultat përgjatë vitit 2020 HANDIKOS ka ofruar më shumë se **600 këshilla juridike** për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe familjarët e tyre. Në kuadër të tyre janë ofruar më shumë se **60 këshilla juridike për ankesa dhe padi**.

HANDIKOS ka adresuar edhe ankesa tek Institucioni i Avokatit të Popullit për mos përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në rimëkëmbjen ekonomike pas **COVID-19**; mbrojtjen nga diskriminimi; & përjashtimin e disa personave me aftësi të kufizuara nga skemat pensionale.

Për më tepër, gjatë vitit 2020, **HANDIKOS** ka asistuar dhe fuqizuar, padinë e bërë për Komunën e Prishtinës **për diskriminim**, e para e këtij lloji në vend.



SHËRBIME TË TJERA

HANDIKOS përgjatë gjithë vitit 2020, përveç ofrimit të shërbimeve të cilat kontribuojnë në mënyrë direkte në objektivat e saj strategjike, ka ofruar edhe shërbime të cilat iu janë përshtatur rrethanave me ballafaqimin e pandemisë me **COVID-19**.

Shërbimet e ofruara përgjatë këtij viti kishin për qëllim të avancojnë kapacitetet e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në sfera të ndryshme; të rrisin kapacitetet e prindërve dhe familjarëve të personave me aftësi të kufizuara për t'i mbështetur ata në kushte shtëpie; si dhe të ngrisin kapacitetet e ofruesve të shërbimeve formal dhe jo formal në mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Sesionet informuese

Përgjatë vitit 2020, HANDIKOS ka realizuar **56** sesione informuese në **28** shkolla të komunës së Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës me qëllim të informimit të fëmijëve me çështjet relevante me aftësinë e kufizuar me fokus në parandalimin e paragjyqimeve, stereotipeve dhe diskriminimit ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Rrjedhimisht, **1038** fëmijë (**577V & 461D**) janë informuar rreth të drejtave dhe sfidave me të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara ballafaqohen. Për të fuqizuar edhe më shumë këtë si dhe për të avancuar qasjen e ofruesve të shërbimeve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, HANDIKOS përgjatë 2020 ka ofruar edhe **26** sesione informuese për teknikat e komunikimit dhe llojet e aftësisë së kufizuar si dhe promovimit të parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara për **497** (**414V & 83D**) ofrues të shërbimeve nga sektori i edukimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.



Me qëllim të mbështetjes së prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përgjatë **COVID-19**, HANDIKOS ka zhvilluar tri (3) sesione informuese me 120 prindër (77G & 43B) duke përdorur platformat virtuale të cilat kanë qenë lehtësisht të qasshme nga prindërit. Qëllimi i këtyre sesioneve kishte të bënte me informimin e prindërve për format e mbështetjes së fëmijëve në kushte të shtëpisë, si dhe përkrahjen e HANDIKOS të përshtatur në ato rrethana, e gjithashtu edhe me parandalimin e përhapjes së **COVID-19** dhe ruajtjen e shëndetit të fëmijëve të tyre. Për më tepër, sesionet në fjalë kanë ndikuar edhe në ruajtjen e gjendjes stabile emocionale të vetë prindërve përgjatë periudhës së krizës. Në anën tjetër katër (4) sesione informuese me 63 të rritur me aftësi të kufizuara (42G & 21B), janë realizuar me qëllim të përkthimit të udhëzimeve për parandalimin e përhapjes së **COVID-19** në një gjuhë miqësore për aftësinë e kufizuar, gjithashtu edhe për të ofruar alternativa të të qëndruarit aktiv përgjatë karantinës.

Trajnime dhe punëtori

HANDIKOS në vazhdimësi ka punuar ngushtë me komunitetin që përfaqëson në ngritjen e kapaciteteve në fusha të ndryshme, përfshirë këtu edhe organizatat e tjera partnere, me të cilat bashkërisht synohet të avancohet situata e personave me aftësi të kufizuara në vend.

Përgjatë këtij viti, HANDIKOS ka organizuar një trajnim me 31 persona me aftësi të kufizuara (14G & 17B) me qëllim të ofrimit të alternativave për jetesë të pavarur si dhe realizimit të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS ka organizuar 10 trajnime me 102 fëmijë me aftësi të kufizuara (56V & 46D) me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre për të identifikuar situatat e mundshme abuzuese, ballafaqimin me to dhe raportimin e tyre.

Fëmijët përfaqësues të **Grupit Avokues "HËNA"** gjatë vitit 2020, përveç angazhimeve të shumta për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ishin pjesëmarrës aktiv edhe në punëtorinë tre ditore të organizuar me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të grupit në fushën e avokimit dhe lobimit. Pjesë e punëtorisë ishin 13 fëmijë me aftësi të kufizuara (5V & 8D) nga komuna e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës.

HANDIKOS gjatë vitit 2020 ka realizuar edhe një (1) trajnim me prindër dhe ofrues të shërbimeve në komunën e Gjakovës për principet e Disiplinës Pozitive në Prindërimin e Përditshëm. Pjesë e trajnimit ishin 14 pjesëmarrës (13G & 1B). Përderisa impakti i trajnimit tek pjesëmarrësit është evidentë tek 328 fëmijë (157V & 171D).


Një nga asetet me vlerë në **HANDIKOS** vazhdon të jetë edhe përkrahja ndaj përfaqësuesve të organizatave të personave me aftësi të kufizuara në vend me theks të veçantë me **Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi** në Kosovë. Gjatë vitit 2020, HANDIKOS ka vazhduar të punojë ngushtë me gjithë përfaqësuesit e Qendrave në fjalë në mënyrë që nevojat e personave me aftësi të kufizuara të adresohen në mënyrën më të mirë të mundshme edhe përgjatë **COVID-19**.

Për më tepër, HANDIKOS gjatë vitit 2020, ka organizuar fillimisht një trajnim me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të menaxherëve të Qendrave të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi me **24** pjesëmarrës (10G & 14B) me qëllim të avancimit të njohurive të tyre në fushën e avokimit si dhe përdorimin e teknikës së avokimit për të siguruar **qëndrueshmëri financiare** të shërbimeve të cilat ofrohen nga Qendrat për adresimin e nevojave të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në vend.

Për më tepër, HANDIKOS përgjatë vitit 2020 ka zhvilluar edhe katër (**4**) punëtori të cilat kanë përfshirë 20 komuna të Kosovës me **39** pjesëmarrës (15G & 24B), përfaqësues të **Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK)**. Qëllim i punëtorive në fjalë ishte të mbështesë kapacitetet e OPAK në avancimin e qeverisjes së brendshme organizative si dhe zhvillimit administrativ, gjë e cila mbështet procesin e përfshirjes së OPAK në proceset politikë-bërëse, relevante me aftësinë e kufizuar në vend.

HANDIKOS ka punuar ngushtë me përfaqësuesit e OPAK edhe përgjatë **punëtorisë tre (3) ditore** për ngritjen e kapaciteteve të organizatave në ngritje të fondeve, me **24** pjesëmarrës (9G & 15B) nga organizatat lokale dhe qendrore në Kosovë.

Gjithashtu, **23** përfaqësues të OPAK (7G & 16B) kanë punuar bashkërisht, përgjatë punëtorisë 3 ditore të organizuar nga HANDIKOS në draftimin e Planit të përbashkët të avokimit i cili për qëllim ka të mbështesë kauzën e OPAK për të **avancuar situatën e personave me aftësi të kufizuara** në vend.




HANDIKOS që nga mesi i muajit Mars 2020, punën e saj e ka zhvendosur kryesisht në platforma virtuale, duke vazhduar të jetë pranë personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre në forma të ndryshme. Fillimisht, HANDIKOS ka marrë zotimin që çdo informatë të ofruar nga institucionet e linjës për mbrojtjen nga virusi **COVID-19** dhe parandalimin e përhapjes së tij, ta përkthej në një gjuhë miqësore për aftësinë e kufizuar. Si rrjedhojë përmes postimeve të zhvilluara dhe publikuara në rrjetet sociale, **HANDIKOS** ka arritur të ngrit vetëdijen e personave me aftësi të kufizuara në ruajtjen e shëndetit të tyre dhe parandalimin e përhapjes së **COVID-19**.

Me ndihmë të mbështetësve vendor dhe të huaj, përgjatë vitit 2020, HANDIKOS ka siguruar mbështetje për **150** persona me aftësi të kufizuar në Kosovë me material shëndetësor, si dhe pako higjienike për **37** fëmijë nga regjioni i Prishtinës. Për më tepër, HANDIKOS ka ofruar **290** pako ushqimore dhe higjienike për **290** familje të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë, janë ballafaquar vazhdimisht me vështirësi në nxënien përmes platformave virtuale nga Ministria e Arsimit. Si rrjedhojë HANDIKOS me mbështetje të donatorëve të saj ka arritur të siguroj pajisje teknologjike për **85** (35V & 50D) fëmijë me aftësi të kufizuara, gjë e cila ua ka mundësuar atyre të ndjekin mësimin në platforma virtuale, e gjithashtu edhe në ndjekjen e shërbimeve virtuale të ofruara përgjatë vitit 2020.


HANDIKOS ka shpërndarë edhe **10,500 maska** për fytyrë dhe më shumë se **200 dezinfektues** për duar përgjatë vitit 2020, shpërndarja e të cilave është lehtësuar nga Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi në Kosovë. Ndërsa **25** persona me aftësi të kufizuara (13G & 12B) nga regjioni i Prishtinës kanë përfituar pako me material informues, maska për fytyrë, dezinfektues dhe pajisje të tjera të cilat kanë lehtësuar ruajtjen e shëndetit përgjatë pandemisë.

Video promovuese, postime dhe informata në suaza të vazhdueshme janë plasuar në rrjetet sociale të HANDIKOS, të cilat kanë mbajtur komunitetin të informuar për zhvillimet në vend rreth menaxhimit të pandemisë, ballafaqimin me situatat pasuese të saj dhe të qëndruarit aktiv përgjatë periudhës së karantinës. Përgjatë një **(1) viti** HANDIKOS ka arritur mbi **600 mijë persona** me postimet e publikuara në rrjete sociale



HANDIKOS edhe gjatë vitit 2020 ka implementuar Procesin e **Fletënotimit Komunitar**, ku me kërkesë të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara është përcaktuar sektori i edukimit, si fushë e cila vlerësohet të jetë me prioritet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në kuadër të procesit, HANDIKOS ka arritur që të përfshijë komunën e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës, me gjithsej **107** pjesëmarrës (ofrues të shërbimeve, fëmijë me aftësi të kufizuara dhe prindër të fëmijëve). Qëllimi i procesit ishte aktivizimi i marrësve dhe ofruesve të shërbimeve në adresimin e çështjeve të cilat ndikojnë situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në **sektorin e arsimit**.

Fëmijët, prindërit dhe përfaqësuesit nga arsimi, së bashku kanë punuar në priorizimin e çështjeve të cilat do duhej t'i adresonin përgjatë periudhës në vazhdim, përmes përpilimit të planeve të veprimit. Çështjet e priorituara për këtë periudhë, kryesisht janë të ndërlidhura me *asistentët dhe mësuesit mbështetës, transportin, vlerësimin, implementimin e PIA-së, bashkëpunimin prindër - mësues dhe materialet didaktike*. Gjatë vitit 2020, HANDIKOS ka arritur të siguroj mbështetje me material didaktik për katër (4) shkollat e targetuara përgjatë procesit.



HANDIKOS vazhdon të punoj me dhe për personat me aftësi të kufizuara, duke i fuqizuar ata në pjesëmarrjen aktive në shoqëri. Përgjatë këtij viti, HANDIKOS ishte pjesë e dëgjimeve publike lokale si dhe takimeve punuese të drejtorive të linjës si në nivelin lokal e gjithashtu edhe në atë qendror, kjo për të reflektuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara në procesin e draftimit të politikave dhe rregulloreve të cilat adresojnë **të drejtat e njeriut** me theks të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, HANDIKOS ka fuqizuar personat me aftësi të kufizuara edhe jashtë regjionit të Prishtinës, në bashkëpunim të ngushtë me rrjetin e **Qendrave të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi** në Kosovë. Si rrjedhojë **1,829** pjesëmarrës (649G & 1177B) ishin pjesë e takimeve të Asambleve Komunale dhe atyre të komiteteve të ndryshme të realizuara përgjatë vitit 2020.

Përgjatë vitit 2020, **HANDIKOS** ka vazhduar të mbështesë Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të Qendrave, me theks të veçantë në qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara. Për këtë qëllim, HANDIKOS përgjatë vitit 2020 ka mbajtur **shtatë (7) punëtori** dy-ditore regjionale, në shtatë (7) regjionet kryesore të Kosovës me **112 pjesëmarrës** (69G & 43B). Pjesëmarrësit ishin nga vetë Qendrat, përfaqësuesit e komunave të përfshira në regjion (drejtoritë komunale të mirëqenies dhe shëndetësisë) si dhe asambleistë komunal.

HANDIKOS ka trajnuar edhe **10 persona me aftësi të kufizuara** (6G & 4B) në fushën e **rrobaqepësisë**, me theks të veçantë në qepjen e çantave shumë përdorimëshe. Të trajnuarit do vazhdojnë pjesën e dytë të trajnimit vitin e ardhshëm dhe do fillojnë të pilotojnë qepjen e çantave shumë përdorimëshe për të kontribuar në largimin e përdorimit të qeseve të plastikës.



INTERVENIME AVOKUESE DHE LOBUESE



INTERVENIME AVOKUESE DHE LOBUESE

Përgjatë vitit 2020 **HANDIKOS** ka vazhduar punën në fushën e avokimit dhe lobimit për të avancuar situatën e personave me aftësi të kufizuara në vend, e me theks të veçantë për të promovuar të drejta të barabarta dhe jetë të dinjitetshme për të gjithë. Përgjatë një (1) viti HANDIKOS ka lansuar dhe implementuar kampanja të ndryshme që në thelb kanë adresuar të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara, qasjen, edukimin, pjesëmarrjen dhe parandalimin e dhunës.

Si një ngjarje tashmë e përvjetshme, edhe këtë vit është shënuar **1 Marsi- Dita ndërkombëtare të përdoruesve të karrocës**, e cila është karakterizuar me parakalimin e fëmijëve dhe të rriturve në karrocë përgjatë sheshit kryesor të Prishtinës me **300** pjesëmarës me moton "*Mos ma kufizo lëvizjen!*". Ngjarja është përcjellur edhe me mesazhe të tjera të cilat portretizojnë jetesën e përdoruesve të karrocës në Kosovë, si: "*Ne k'shtu lëvizim*"; "*Edhe unë kam rrota por nuk e ndot ambientin*"; "*Ku shkel këmba jote, të shkelë rrota jem*"; "*Veç punën, se karrigen e kom*"; "*Rampë për rrota*" etj. Kampanja e 1 Mars-it është përmbyllur me një vallëzim të përbashkët me të gjithë të pranishmit, përderisa ngjarja është përcjellur nga mediat. E gjithë kjo ka arritur një shikueshmëri prej mbi **60.000** njerëz në rrjetet sociale.

HANDIKOS vazhdon të punoj ngushtë me të gjithë partnerët e saj në mbrojtjen e fëmijëve me theks tek fëmijët me aftësi të kufizuara. Këtë e reflekton në programet e saj intervenuese dhe avokuese. Këtë vit, HANDIKOS në partneritet me Grupin e Fëmijëve "HËNA" dhe ROR, Syri i Vizionit dhe Save the Children kanë lansuar kampanjën "**Unë pa dhunë!**", kampanjë kjo e cila ka përcjellur mesazhe të fëmijëve për promovimin e ambientit të sigurtë për të gjithë fëmijët, e veçanërisht për periudhën që lamë pas, periudhë kjo e cila vlerësohet të ketë rritur numrin e rasteve të dhunës në familje. Kampanja është shoqëruar me video dhe foto mesazhe të vetë fëmijëve, përderisa ka arritur mbi **32.000** shikues përmes rrjeteve sociale.

Edukimi gjithëpërfshirës vazhdon të mbetet një ndër objektivat kyçe të **HANDIKOS**, objektivë kjo e cila çdo vit fuqizohet përmes ofrimit të shërbimeve të caktuara si për vetë fëmijët me aftësi të kufizuara e gjithashtu edhe për prindërit, ofruesit e shërbimeve apo edhe politikë-bërësve. HANDIKOS gjatë vitit 2020 ka lansuar kampanjën "**Shkolla hap dyert e botës!**" kampanjë kjo e cila për qëllim kishte të rrisë vetëdijen e shoqërisë lidhur me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e rregullt të edukimit; vështirësitë me të cilat fëmijët ballafaqohen përgjatë këtij procesi; si dhe promovimin e alternativave të cilat lehtësojnë procesin e përfshirjes së fëmijëve në sistemin edukativ.

Kampanja është përmbyllur me lansimin e një (1) instalacioni në sheshin e Prishtinës, me të njëjtën tematikë. Instalacioni për më tepër ka ftuar përfaqësues të institucioneve të ndryshme për t'u zotuar rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në edukim. Përgjithësisht, kampanja ka arritur të përfshijë mbi **200.000** njerëz, ndërsa përkushtimin rreth gjithëpërfshirjes e kanë deklaruar më shumë se **50 përfaqësues** të institucioneve të linjës.

Me rastin e shënimit të **3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara**, HANDIKOS ka realizuar dy konferenca me qëllim të fuqizimit të zërit të vetë personave me aftësi të kufizuara. Të dyja konferencat kanë theksuar situatën e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në vend, ku theks i veçantë iu është dhënë situatës së tyre përgjatë **COVID-19** dhe sfidave me të cilat janë ballafaquar. Konferencat janë zhvilluar përmes platformave virtuale, ku numri i pjesëmarrësve të përfshirë në formë direkte ishte rreth **100**, ndërkaq e njëjta është përcjellur edhe nga publiku i gjerë përmes video live në Facebook ku është arritur një vijueshmëri prej **3000** shikues.

Të tjera

HANDIKOS përgjatë gjithë vitit duke shfrytëzuar resurset e saj ka arritur të jetë pranë qytetarëve me aftësi të kufizuara në forma dhe kohë të ndryshme, ku, përmes bashkëpunimit me Qendrat e Rehabilitimit të Bazuara në Bashkësi dhe OPAK, përgjatë një (1) viti janë implementuar intervenime të shumta avokuese, me qëllim të sensibilizimit të shoqërisë rreth çështjeve relevante me aftësinë e kufizuar. Në Lipjan është mbajtur një diskutim i hapur me **20** pjesëmarrës (9G, 11B) me qëllim të ngritjes së vetëdijes për diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara. Diskutime të hapura janë realizuar edhe në komunën e Suharekës me temën "*Ngritja e vetëdijes së institucioneve dhe komunitetit për të drejtën e lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara*", diskutime këto të cilat janë udhëhequr nga vetë personat me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën linjë, në Mitrovicë janë shpërndarë broshura informative rreth Udhëzimit Administrativ 33/2007. Ndërkaq, në Prishtinë është lansuar një video vetëdijësuese me moton "**Aty ku s'ka qasje, ka diskriminim!**", video kjo e cila ka arritur **123.000** shikime në rrjetet sociale.

HANDIKOS me mbështetjen e donatorëve, edhe këtë vit ka arritur të realizoj intervenime lokale me qëllim të rritjes së vetëdijes rreth përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset. Në komunën e Ferizajt, është vendosur një (1) **luhatëse e qasshme** për fëmijë me aftësi të kufizuar ndërsa në komunën e Gjakovës janë vendosur tri (3) luhatëse të tilla, nga të cilat përlllogaritet të jenë përfitues më shumë se **150 fëmijë** me aftësi të kufizuara nga këto komuna.

PUBLIKIME

Viti 2020 konsiderohet të jetë i suksesshëm në realizimin e programeve të përvjetshme të **HANDIKOS** e gjithashtu edhe impakti dhe progresi i arritur në objektivat dhe programet strategjike të saj. Përgjatë një (1) viti, HANDIKOS me partnerët e saj ka punuar ngushtë edhe në validimin dhe faktimin e situatës së personave me aftësi të kufizuara në vend.

- Është publikuar raporti **"Ku qëndron Kosova?"** - raport ky i cili ka informuar vendim marrësit dhe palët e tjera të interesit lidhur me zbrastësitat dhe mangësitë e kornizës ligjore Kosovare në krahasim me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe ligjet e aplikueshme Evropiane. Raporti i plotë mund të shkarkohet këtu: http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Report_SHQ-29_04_20_95548.pdf
- HANDIKOS ka lehtësuar edhe qasjen ndaj personave me aftësi të kufizuar nga komuniteti dhe institucionet e linjës, përmes publikimit të hulumtimit **"Mirëqenia e personave me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19"** - publikim ky i cili ka përfshirë informata rreth aftësisë së kufizuar dhe COVID-19, këshilla për menaxhimin e stresit përgjatë pandemisë si dhe këshilla për familjarët, komunitetin dhe politikë-bërësit në adresimin e çështjeve relevante me aftësinë e kufizuar. Hulumtimi i detajuar mund të shkarkohet këtu http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/05/Hulumtimi_final_COVID-19_592381.pdf
- HANDIKOS për më shumë se një (1) vit ka punuar ngushtë me Drejtoritë Komunale të Arsimit në shtatë (7) regjionet e Kosovës me **144 shkolla** në Kosovë me qëllim të vlerësimit të nivelit të qasshmërisë që ato ofrojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga **50,550** nxënës të përfshirë në shkollat e vlerësuara është raportuar që **vetëm 2%** e tyre të jenë me aftësi të kufizuar, përderisa nuk është identifikuar asnjë shkollë e cila ofron standarde të plota për lëvizjen e lirë për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë. Më shumë se 56% të shkollave të vlerësuara nuk ofrojnë rampa standarde, e vetëm 7% e tyre kanë toalete të qasshme për nxënësit me aftësi të kufizuara. Raporti i detajuar mund të shkarkohet këtu: <http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/RAPORTI-I-VLERE%CC%88SIMIT-TE%CC%88-QASSHME%CC%88RISE%CC%88-SE%CC%88-NDE%CC%88RTESAVE-SHKOLLORE-TE%CC%88-NIVELIT-FILLOR-DHE-MESE%CC%88M-TE%CC%88-ULE%CC%88T-PE%CC%88R-FE%CC%88MIJE%CC%88T-ME-AFTE%CC%88SIT-TE%CC%88-KUFIZUARA-NE%CC%88-KOSOVE%CC%88.pdf>

- HANDIKOS gjatë vitit 2020, punën e bërë drejt avancimit të situatës së personave me aftësi të kufizuara në vend e ka validuar dhe faktuar edhe përmes publikimit të **Raportit Vjetor për Aftësinë e Kufizuar** – Ku Qëndron Kosova? – raport ky i cili përmbledh dhe thekson situatën e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë përgjatë **COVID-19**, në fushën e edukimit, qasjen, punësimin, pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin ndërkombëtarë. Raporti ka nxjerrur në pah vështirësitë kyçe me të cilat fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara janë ballafaquar përgjatë vitit 2020 me theks të veçantë vështirësitë dhe implikimet si rezultat i pandemisë me **COVID-19**. Raporti mund të shkarkohet këtu: http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/404-535_Raporti_Vjetor_AK_03_Dhjetor_2020.pdf
- Së fundmi, **HANDIKOS** punën e saj një (1) vjeçare rreth promovimit të parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara e ka finalizuar përmes publikimit të **"Raportit të shkurtër rreth përdorimit të bazës së disagreguar për fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në dhunë në familje"** – raport ky i cili tregon që asnjë fëmijë me aftësi të kufizuar i përfshirë në dhunë në familje nuk është raportuar të jetë i/e regjistruar në bazën e të dhënave e cila menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë. Në anën tjetër raporti nxjerr në pah edhe vështirësitë rreth përdorimit të bazës së të dhënave e me theks të veçantë, vështirësitë si pasojë e **COVID-19**. Raporti i detajuar mund të shkarkohet këtu: <http://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/RAPORT-I-SHKURTE%CC%88R-RRETH-PERDORIMIT-IE%CC%88-BAZE%CC%88S-SE%CC%88-TE%CC%88-DHE%CC%88NAVE-PE%CC%88R-FE%CC%88MIJE%CC%88T-ME....pdf>



Rr. "Nekibe Kelmendi", nr. 80, Prishtinë
Telefoni: 049 970 588
Email: handikose@handi-kos.org
Webfaqja: <http://handi-kos.org/>